



iPROCEEDS

Projekt për vënien në shënjestër të produkteve
të veprës penale në Internet në Evropën
Juglindore dhe Turqi

Version i 17 majit 2017

Udhëzues i Përgjithshëm për Protokollet e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për hetimet që përfshijnë produktet nga veprat penale online

Funded
by the European Union
and the Council of Europe



Implemented
by the Council of Europe

Përmbajtja

Udhëzues i përgjithshëm për Protokollet e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për hetimet që përfshijnë produktet nga veprat penale online	4
Hyrje	4
Institucionet e duhura	4
Parimet	5
Bashkëpunimi ndërinstitucional	5
Bashkëpunimi gjatë hetimeve penale	5
Format e përgjithshme të bashkëpunimit	6
Bashkëpunimi Ndërkombëtar	6
Shtojca: Raport shpjegues	9
1. Hyrje	10
1.1 Qëllimi dhe historiku	10
1.2 Shënim shpjegues	10
1.3 Shkëmbim i informacionit / kërkesave	10
1.4 Hetimi penal	11
1.5 Objekti / Zbatueshmëria	11
2. Masat	13
2.1 Masat e brendshme/në nivel vendi	13
2.2 Masat në nivel ndërkombëtar	13
3. Bashkëpunimi gjatë hetimeve penale	15
3.1 Hetimi paraprak	15
3.2 Nisja e hetimit	15
3.3 Bashkëpunimi në lidhje me shkëmbimin e informacionit	15
4. Shkëmbimi i informacionit të përpunuar kriminal, informacionit të thjeshtë dhe provave	16
5. Grupe multi-institucionale	17
5.1 Ngritja e Grupit multi-institucional	17
5.4 Bashkëpunimi i Teknologjive	18
5.5 Analizimi dhe Raportimi	18
5.7 Trajnim i përbashkët	19
5.8 Bashkëpunimi joformal	19
5.9 Pikat e kontaktit për Grupet multi-institucionale	19
5.1 Bërja publike	20
5.2 Përfundimi i Grupeve shumë-institucionale	20
5.3 Shpenzimet	20
6. Bashkëpunimi ndërmjet sektorit publik dhe privat	21
7. Bashkëpunimi ndërkombëtar	22
7.1 Ekipet e përbashkëta hetimore	22
7.2 Standardet ndërkombëtare	23

Instrumentet ligjore të BE-së.....	23
7.3 Vlerësimi i zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare	27
8. Statistikat.....	30
8.1 Mbledhja e statistikave	30
8.1 Analizimi i statistikave	31
9. Rekomandime për hartimin e protokolleve	31
9.1 Udhëzime të përgjithshme.....	31
9.2 Ndryshime dhe shtesa të protokolleve	32

Udhëzues i përgjithshëm për Protokollet e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për hetimet që përfshijnë produktet nga veprat penale online

Hyrje

1. Hetimet e brendshme dhe ato ndërkombëtare që përfshijnë krimin kompjuterik, marrjen e provave elektronike, produktet nga veprat penale në internet dhe pastrimin e parave kalojnë nëpër institucione të ndryshme dhe kërkojnë përfshirjen në veçanti të njësive të krimit kompjuterik, njësive të hetimit financiar, Njësive të Inteligjencës Financiare dhe shërbimeve të prokurorisë. Bashkëpunimi efektiv ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për të identifikuar dhe ndjekur penalisht autorët e krimit, identifikuar dhe gjurmuar produktet e veprës penale online me qëllim konfiskimin dhe për të parandaluar dhe ndjekur penalisht pastrimin e parave është thelbësor.
2. Qëllimi i këtij dokumenti është të ndihmojë institucionet të përmirësojnë bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar dhe - nëse është e nevojshme - ta formalizojnë këtë bashkëpunim nëpërmjet protokolleve ndërmjet tyre.
3. Baza për bashkëpunim do të jetë kuadri ligjor ekzistues, duke marrë parasysh edhe Marrëveshjet e Mirëkuptimit ekzistuese ndërmjet institucioneve përkatëse.
4. Duke njohur rëndësinë e bashkëpunimit me njëri-tjetrin, brenda përgjegjësive ligjore respektive që ato kanë dhe rëndësinë e ndarjes në kohë të informacionit dhe e të dhënave në hetime konkrete penale, veçanërisht në rastet që përfshijnë krimin kompjuterik, gjurmimin e produkteve të veprës penale dhe pastrimin e parave online, institucionet duhet të identifikojnë dhe eksplorojnë protokollet e mundshme të bashkëpunimit për të arritur bashkëpunim të koordinuar, në kohë dhe efektiv.
5. Synimet e protokollit të brendshëm/në nivel vendi janë:
 - Të bashkojë të gjitha institucionet e duhura për të bashkëpunuar në mënyrë më efektive.
 - Të eliminojë pengesat praktike që hasen gjatë hetimeve të produkteve të veprës penale në internet.
 - Të identifikojë më me efektivitet autorët e veprave penale, t'i ndjekë penalisht dhe t'i sjellë kriminelët para drejtësisë dhe të çojë në sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve nga veprat penale në internet.
 - Të specifikojë rrugët e mundshme të bashkëpunimit ndërkombëtar, në lidhje me kontrollin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve nga veprat penale në internet dhe të identifikojë mundësitë dhe pengesat.
6. Ekzistenca e protokolleve të brendshme synon gjithashtu të krijojë besim dhe bashkëpunim më të madh me partnerët ndërkombëtarë.

Institucionet e duhura

7. Institucionet nga të cilat zbatohet një protokoll mund të përfshijnë, për shembull

- Strukturat e Prokurorisë
- Ministrinë e Punëve të Brendshme - Sektori i Krimit Kompjuterik
- Ministrinë e Punëve të Brendshme - Njësinë e Mjekësisë Ligjore Dixhitale
- Ministria e Punëve të Brendshme - Sektorin e Pastrimit të Parave
- Drejtorinë e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave (DPPPP – FIU/ NjIF Shqiptar)
- Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin e Marrëdhënieve me Juridiksionet e Huaja
- Agjencinë për Administrimin e Aseteve të Konfiskuara dhe Sekuestruara
- Agjencinë Kombëtare për Shoqërinë e Informacionit (AKSHI)
- Shërbimin Informativ Shtetëror, Seksionin e Krimit Kompjuterik
- Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)
- Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT).

8. Këto institucione bashkëpunojnë me njëri-tjetrin në bazë të roleve, përgjegjësi dhe kompetencave të përcaktuara ligjorisht. Këto institucione mund të ftojnë vëzhgues nga institucione të tjera publike për të marrë pjesë në takimet e tyre të rregullta ose operationale, nëse ekspertiza ose njohuria e tyre konsiderohet të nevojshme për bashkëpunimin

Parimet

9. Institucionet bien dakord me parimet e mëposhtme:

- Ekziston nevoja për një bashkëpunim **efektiv** midis agjencive dhe shkëmbimi **efikas** i informacionit është shtyllë kryesore e këtij bashkëpunimi.
- Çdo institucion merr dhe / ose kontrollon informacionin që mund të jetë i dobishëm për një hetim që përfshin produkte të veprës penale online.
- Institucionet do të kenë akses ndaj të dhënave dhe do të ndajnë informacion në përputhje me **dispozitat ligjore** ekzistuese, duke përfshirë **kërkesat për mbrojtjen e të dhënave**.
- Hetimet që përfshijnë produktet e veprave penale online mund të kërkojnë përgjigje **në kohë** ndaj kërkesave të institucioneve të tjera dhe të gjitha institucionet përkatëse janë të gatshme të marrin masapërgjegjësi në këtë drejtim.
- Hetimet që përfshijnë veprimin e përbashkët të disa agjencive kërkojnë **koordinim**.
- Proceset e bashkëpunimit duhet të jenë sa më efikase për t'u përdorur në një numër mundësisht sa më të madh të rasteve të përshtatshme dhe, në veçanti, që ekzistenca e këtyre proceseve të mos pengojë bashkëpunimin ndërinstitutional ekzistues.
- Ekziston nevoja për një **program trajnimi të përbashkët** për krimin kompjuterik, provat elektronike, hetimet financiare dhe produktet e veprave penale online.
- Ekziston nevoja për **takime të rregullta vjetore** ndërmjet institucioneve për të diskutuar, identifikuar dhe mbrojtur mënyrat për përmirësimin e bashkëpunimit, për t'u marrë me sfidat praktike dhe për të adresuar çështje të reja.

Bashkëpunimi ndërinstitutional

Bashkëpunimi gjatë hetimeve penale

10. Institucionet njohin rëndësinë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit në hetimin penal konkret që përfshijnë produktet e veprës penale online (me elemente të krimit kompjuterik, gjurmimin e produktet e veprës penale online dhe pastrimin e parave).
11. Institucionet do të kenë akses ndaj të dhënave dhe do të ndajnë informacion në përputhje me dispozitat ekzistuese ligjore dhe në përputhje me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave.
12. Institucionet do t'u përgjigjen kërkesave urgjente për informacion me marrjen e kërkesës nga një institucion tjetër lidhur me një hetim për krimin kompjuterik ose hetimin e produkteve nga krimi

në internet. Është me vend që kërkesat urgjente të shënohen si të tilla nga institucioni kërkues dhe të përfshihet motivimi përse shënohen si urgjente.

13. Shërbimi i Prokurorisë (prokurori përgjegjës) do të shqyrtojë nevojën për përfshirjen e njësive / institucioneve përkatëse kur vihen në shënjestër produktet e veprës penale online.
14. Gjatë një hetimi, Shërbimi i Prokurorisë (prokurori përgjegjës) do të shqyrtojë formën e duhur të bashkëpunimit rast pas rasti dhe kjo mund të përfshijë, për shembull, krijimin e një task-force, takime të rregullta ose forma të tjera të bashkëpunimit.
15. Hetimet që përfshijnë veprime të përbashkëta të disa institucioneve mund të kërkojnë koordinim operacional nën udhëheqjen e prokurorit, duke përfshirë koordinimin e veprimtarive të disa agjencive. Njësia drejtuese e hetimit do të jetë përgjegjëse për koordinimin e aktivitetit operacional, me të gjitha veprimet e kryera sipas udhëzimeve të prokurorit dhe me raportet e rregullta që i sigurohen ati.
16. Duhet të merret në konsideratë ngritja e një platformë elektronike për shkëmbimin e informacionit ndërmjet Policisë dhe Prokurorisë.

Format e përgjithshme të bashkëpunimit

17. Të paktën një herë në vit, duhet të organizohet një program trajnimi / seminar, ku përfaqësuesit nga secili prej institucioneve do të shkëmbejnë praktikat dhe përvojat më të mira në lidhje me hetimet e produkteve të veprave penale online dhe do të diskutojnë pyetje të hapura dhe mundësi për të përmirësuar bashkëpunimin. Aty ku është e përshtatshme, mund të merret në konsideratë përfshirja e vëzhguesve të sektorit publik ose subjektet e duhura të sektorit privat.

Prezantimet mund të përfshijnë tema të tilla si:

- a. Roli dhe kompetencat e institucionit të tyre kur bëhet fjalë për hetimet që përfshijnë produkte të veprës penale online.
- b. Natyra e informacionit në dispozicion të atij institucioni.
- c. Procesi i angazhimit me atë institucion në çështjet që kërkojnë bashkëpunim.

18. Trajnimi do të organizohet çdo vit nga një prej institucioneve, me rotacion.
19. Çdo institucion do të konsiderojë integrimin e bashkëpunimit ndërinstytucional me objektiv trajnimit në fushën e produkteve të veprave penale online në programet e tyre vjetore të trajnimit.
20. Do të zhvillohen takime të rregullta vjetore të drejtuesve të institucioneve ose njësive përkatëse me qëllim përmirësimin e bashkëpunimit. Drejtuesit e institucioneve përkatëse, me vendim unanimit, mund të përcaktojnë udhëzime të mëtijshme që rregullojnë aspektet e bashkëpunimit të institucioneve të tyre.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar

21. Bashkëpunimi në rritje i institucioneve përkatëse në nivel kombëtar pasqyron gjithashtu nevojën për një bashkëpunim të koordinuar ndërkombëtar nëpërmjet shkëmbimit të informacionit dhe ndihmës së ndërsjellë juridike. Institucionet përkatëse do të identifikojnë dhe shqyrtojnë

protokollet e mundshme të bashkëpunimit për të arritur një bashkëpunim ndërkombëtar të koordinuar, në kohë dhe efektiv.

22. Institucionet janë të vetëdijshme për opsione të ndryshme për bashkëpunim ndërkombëtar bazuar në legjislacionin vendas (Kodi i Procedurës Penale dhe Ligji për Marrëdhënie me Juridiksione të Huaja në Çështjet Penale), përfshirë atë në bazë të reciprocitetit, instrumentet ligjore ndërkombëtare në fushën e pastrimit të parave, kontrollit, sekustrimit dhe konfiskimit të produkteve të veprave penale, krimit kompjuterik dhe pastrimit të parave (Këshilli i Evropës Strasburg, Konventat e Varshavës dhe Budapestit, Konventa Evropiane për Asistencën e Ndërsjellë në Çështjet Penale dhe protokollet shtesë¹) dhe marrëveshjet dypalëshe¹.

23. Pikat kombëtare të kontaktit për shkëmbimin e informacionit:

- CARIN: Drejtorja e Krimit Ekonomik, Policia e Shtetit Shqiptar
- EUROPOL (EC3): Policia e Shtetit Shqiptar
- INTERPOL: Policia e Shtetit Shqiptar
- EUROJUST: Prokuroria e Përgjithshme
- Grupi EGMONT: DPPP
- Pika e kontaktit 24/7 në Konventën e Budapestit: Sektori i Krimit Kompjuterik, Ministria e e Punëve të Brendshme
- SELEC: Policia e Shtetit Shqiptar

24. Autoriteti qendror për ndihmë të ndërsjellë juridike është Ministria e Drejtësisë:

- Konventat e Këshillit të Evropës Strasburg, Varshavë dhe Budapest,
- Konventa e Palermos e OKB-së
- Marrëveshjet rajonale / bilaterale.

25. Institucionet njohin shumëllojshmërinë e mundësive dhe opsioneve për bashkëpunim ndërkombëtar në kuadër të përgjegjësive të tyre ligjore në hetimet konkrete penale që përfshijnë produktet e veprave penale në internet: me elemente të krimit kompjuterik, gjurmimin e të ardhurave nga krimi dhe pastrimin e parave.

26. Institucionet do të vazhdojnë t'u japin informacion të tjerëve për natyrën dhe llojin e informacionit që mund të kërkohet në nivel ndërkombëtar, brenda përgjegjësisë së tyre, si dhe proceset dhe afatet e përfshira.

27. Institucionet do të vazhdojnë të konsiderojnë dhe të eksplorojnë mundësi të ndryshme për përdorimin e kanaleve për bashkëpunim ndërkombëtar në një rast, në përputhje me dispozitat ligjore ekzistuese.

28. Prokurorët do të konsiderojnë qasjen e mundshme në rastet konkrete për:

- a. Shkëmbimin e informacionit përmes rrjeteve ekzistuese (si Grupi EGMONT, Europol EC3, EUROJUST), Rrjeti 24/7, aksesit ndaj informacionit nëpërmjet bashkëpunimit vullnetar të ofruesve të shërbimeve multinacionale,

¹ Marrëveshjet bilaterale për asistencë të ndërsjellë juridike në çështjet penale me Republikën Çeke, Greqinë, Kosovën*, "ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë" dhe Turqinë.

* Emërtimi nuk paragjykon pozicionet mbi statusin dhe është në përputhje me Opinionin e GJND-së mbi Deklaratën e Pavarësisë së Kosovës.

- b. transmetimin e kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike, sipas dispozitave të legjislacionit kombëtar dhe instrumenteve ligjore ndërkombëtare,
 - përmes autoriteteve qendrore për ALN-në;
 - duke përdorur opsionet e parashikuara nga Konventa e Varshavës (Neni 34) ose Konventa e Budapestit (Neni 25 dhe 27 respektivisht) ose çdo mundësi tjetër shumëpalëshe ose dypalëshe.
29. Institucionet, të udhëhequra nga Prokurori, do të konsiderojnë përfitimet nga përdorimi i hetimeve të përbashkëta dhe ekipeve të përbashkëta të hetimit ose organeve të posaçme (ad hoc) të ngjashme në rastet ndërkufitare. Kur krijohet një ekip i përbashkët hetimi, prokurori kryesor ose njësia kryesore duhet të përcaktojë detyrat me qëllim që të shmangët dublikimi i kërkesave për informacionit nëpërmjet rrjeteve të ndryshme.
30. Institucionet duhet të përdorin dhe ndajnë praktikatat e mira dhe udhëzimet e ofruara nga institucionet përkatëse ndërkombëtare, siç është Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Funksionimin e Konventave Evropiane për Bashkëpunimin në Çështjet Penale (PC-OC), Komiteti i Konventës së Krimit Kompjuterik (T-CY), Konferencën e Palëve në Konventën e Varshavës, dhe të tjerë. Përfaqësuesit kombëtarë u ofrojnë institucioneve përkatëse përditësime mbi zhvillimet.
31. Institucionet informojnë njëri tjetrin, të paktën një herë në vit, për statistikat e bashkëpunimit ndërkombëtar në lidhje me produktet e veprave penale online, si dhe për praktikatat më të mira dhe përvoja të tjera.

Shtojca: Raport shpjegues

Raport shpjegues

mbi

Udhëzuesin e përgjithshëm për Protokollat e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për hetimet që përfshijnë produktet nga veprat penale online

1. Hyrje

1.1 Qëllimi dhe historiku

Qëllimi i këtij dokumenti është të sigurojë një burim referimi për agjencitë e përfshira në hetimin dhe ndjekjen penale të krimit kompjuterik dhe kontrollin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve nga veprat penale online dhe plotësimin e informacionit në Udhëzuesin e Përgjithshëm mbi Protokollin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për hetimet që përfshijnë produkteve nga veprat penale online.

Dokumenti përmban aspekte dhe mundësi të ndryshme për bashkëpunimin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar, si dhe disa konsiderata në lidhje me protokollin e brendshme të një vendi.

Ky dokument është projektuar për të ndihmuar prokurorët, hetuesit dhe entitetet e tjera relevante që të formojnë një kuadër strategjik mbi të cilin do të bazohet shkëmbimi efektiv dhe bashkëpunues i informacionit dhe grupit të hetimit gjatë punës në partneritet me agjencitë e tjera publike dhe / ose pjesë të sektorit privat për të kontrolluar, sekuestruar dhe konfiskuar produktet nga veprat penale në internet.

Interesi i përbashkët është t'i çojmë kriminelët para drejtësisë dhe t'i privojë ata nga fitimi kriminal.

1.2 Shënim shpjegues

Bashkëpunimi ndërinstitucional varet nga kuadri ligjor kombëtar, i cili përcakton rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse, duke përfshirë edhe ato raste që kombinojnë aspektet e hetimit në internet, hetimin financiar dhe parandalimin dhe hetimin e pastrimit të parave online.

Intensiteti i bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse mund të ndryshojë nga shkëmbimi i thjeshtë (spontan) i informacionit ose dërgimi i kërkesave për përgjigje në një institucion tjetër, deri në krijimin e ekipeve hetimore më të strukturuar në nivel operacional.

Dokumentet mbi protokollin ndërinstitucional dhe ndërkombëtar duhet të rishikohen dhe përditësohen rregullisht, mundësisht në mbledhjet vjetore të mbajtura midis të gjitha institucioneve përkatëse që u referohemi në kuadër të këtij dokumenti.

1.3 Shkëmbim i informacionit / kërkesave

Është kuptimi i vlerës së angazhimit ndërmjet institucioneve të ndryshme që nxit vendimin për të bashkëpunuar. Prandaj, është më vend të shqyrtohet nëse komunikimi ndërmjet institucioneve (Policisë së Shtetit, NjIF-i dhe Shërbimit të Prokurorisë) është i centralizuar (nga pikat kontakti dhe kanale komunikimi të përcaktuara - për shembull në një marrëveshje mirëkuptimi) ose nëse mënyra e komunikimit duhet t'i lihet vendimit që do të marrin drejtuesit e njësisë në institucionet përkatëse rast pas rasti. Mund të ketë përfitime nga shkëmbimi i centralizuar i informacionit / kërkesave, por me fleksibilitet operacional.

Shkëmbimi i tillë i informacioneve / kërkesave mund të ndodhë edhe para fillimit zyrtar të hetimit penal, kështu që prokurori mund të mos jetë i angazhuar (ende) me drejtimin. Nëse prokurori duhet të informohet për një komunikim të tillë varet nga marrëveshjet ligjore dhe praktike.

1.4 Hetimi penal

Në Shqipëri, shërbimi i prokurorisë së shtetit përbëhet nga një shërbim i vetëm që vepron nga zyrat rajonale duke i ndarë rastet bazuar në një sistem lotarie. Prokurori ka kompetencën ligjore të fillojë dhe drejtojë hetimet penale me mbështetje operacionale nga policia mbi të cilën prokurori ka një rol drejtues dhe mbikëqyrës. Megjithatë, një mbikëqyrje e tillë nuk shtrihet tek NjIF-ja (DPPPP), e cila është në varësi të Ministrit të Financave. Praktika aktuale është që bashkëpunimi ndërmjet shërbimit të prokurorisë dhe DPPPP-së ndodh rast-pas-rasti bazuar në vullnetin e të dy institucioneve.

Shërbimi i prokurorisë mund të krijojë seksione të specializuara brenda vendit, në rastet që kërkojnë një lloj të veçantë të ekspertizës. Prokurori mund të komunikojë me institucionet / agjencitë e nevojshme dhe të vendosë se kë duhet të përfshijë - duke iu nënshtruar kërkesës për ruajtjen e sekretit të hetimit, që kërkon që të arrihet një ekuilibër mes nevojës për të ruajtur fshehtësinë dhe nevojës që të përparojë hetimi. Kjo nuk është pengesë për përfshirjen e subjekteve të tjera brenda një hetimi nëse një gjë e tillë është e nevojshme.

Përgatitjet e përshkruara më sipër janë të ndryshme nga "task forcat" të cilat janë krijuar për t'u marrë me një klasë të caktuar rastesh ose fenomeni specifik.

1.5 Objekti / Zbatueshmëria

Institucionet përkatëse në vijim janë të angazhuara në kontrollin, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprave penale online:

- Prokuroria e Përgjithshme
- Ministria e Punëve të Brendshme - Sektori i Krimit Kompjuterik
- Ministria e Punëve të Brendshme - Sektori i Pastrimit të Parave
- Ministria e Punëve të Brendshme - Njësia Dixhitale e Policisë Shkencore
- Ministria e Financave - Drejtoria e Përgjithshme për Parandalimin e Pastrimit të Parave -DPPPP (Njësia e Inteligjencës Financiare - FIU shqiptar)
- Ministria e Drejtësisë - Departamenti i Marrëdhënieve me Juridiksionet e Huaja
- Agjencia për Administrimin e Aseteve të Konfiskuara dhe Sekuestruara.

Mandati i secilit institucion:

- **Prokurori i Përgjithshëm** ka një sërë rolesh kur merret me krimin kompjuterik dhe krime në të cilat kriminelët fitojnë të ardhura. Prokurorët marrin drejtimin në të gjitha hetimet penale dhe drejtojnë agjencinë përkatëse të zbatimit të ligjit në lidhje me detyrat që duhet të kryejnë. Prokurorët mbështeten në bashkëpunimin e ngushtë me oficerët nga të gjitha institucionet përkatëse që janë objekt i fushëveprimit të këtij dokumenti për të përshpejtuar detyrat e tyre me qëllim që hetimet të përfundojnë në mënyrë sa më efikase. Prokurorët gjithashtu janë të autorizuar që të kenë ekipin e tyre të hetimit të cilën mund ta kontrollojnë dhe ta ngarkojnë drejtpërsëdrejti me detyra. Kjo siguron një nivel më të lartë bashkëpunimi me oficerët e zbatimit të ligjit. Në lidhje me krimin kompjuterik dhe marrjen e provave elektronike, bazuar në KPP, prokurori ka kompetenca specifike për marrjen e masave urgjente, siç është urdhërimi i ruajtjes së përshpejtuar të të dhënave brenda një periudhe prej 90 ditësh, kur ka arsye për të besuar se të dhënat mund të humbasin ose të dëmtohen. Ai gjithashtu mund të urdhërojë zbulimin e përshpejtuar të trafikut të të dhënave dhe - në raste të veçanta - marrjen e informacionit për abonentin që i nënshtrohet shqyrtimit gjyqësor brenda 48 orëve - nxjerrja e urdhrave që kërkojnë dorëzimin e të dhënave të abonentit nga ata që i mbajnë këto të dhëna zakonisht lëshohen nga

gjykata me kërkesën e prokurorit. Po kështu, urdhrat për kontroll dhe sekuestrim lëshohen nga gjykata me kërkesën e prokurorit.

Në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar, prokurori ka kompetencën të dërgojë dhe të marrë kërkesa - me kusht që të informojë Ministrinë e Drejtësisë (autoritetin qendror) - dhe gjithashtu punon me PK 24/7 në lidhje me kërkesat urgjente për ruajtje.

- **Ministria e Punëve të Brendshme – Sektori i Krimit Kompjuterik** punon nën drejtimin e prokurorit në lidhje me hetimet për krimin kompjuerik dhe siguron mbështetje operacionale për mbledhjen e provave, megjithatë, siç është treguar më lart, kompetencat e ruajtjes u mbeten prokurorisë dhe gjykatave. Njësia gjithashtu ka një rol ndërgjegjësues në lidhje me krimin kompjuerik dhe siguron mbështetjen e duhur për departamentet e tjera qeveritare, p.sh. Ministrinë e Teknologjisë së Informacionit, por nuk ka kapacitete për Njësinë Dixhitale të Policisë Shkencore. Ajo gjithashtu bashkëpunon me agjencitë në sektorin financiar dhe me Ofruesit e Shërbimit të Internetit (OSHI-të). PK-ja e rrjetit 24/7 (sipas nenit 35 të Konventës së Budapestit) vendoset brenda njësisë dhe PK-ja lehtëson kërkesat për ruajtje nga homologët e vendeve të tjera, të cilat autorizohen nga prokurori dhe / ose gjykatat. Njësia gjithashtu bashkëpunon me homologët e policisë nëpërmjet kanaleve të Europol-it dhe INTERPOL-it.
- **Ministria e Punëve të Brendshme - Sektori i Pastrimit të Parave** Ekzistojnë hetues të specializuar brenda kësaj njësie për të kryer hetime financiare. Ato mund t'u ofrojnë asistencë dhe mbështetje edhe njësive të tjera, siç është sektori i Krimit Kompjuterik, dhe anasjelltas.
- **Ministri i Financave - Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave - DPPPP (Njësia e Inteligjencës Financiare - NjIF)** i nxjerrë kompetencat e veta nga Ligji "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të Terrorizmit. Roli kryesor i NjIF-së është të marrë dhe analizojë raportet për transaksionet e dyshimta dhe informacione të tjera që kanë të bëjnë me pastrimin e parave, veprat penale mëmë dhe financimin e terrorizmit, dhe t'ua dërgojë rezultatet e analizës së vet Prokurorisë së Përgjithshme dhe / ose autoriteteve kompetente të zbatimit të ligjit. NjIF-ja është anëtare e Grupit EGMONT, një rrjet ndërkombëtar me 152 NjIF, që mundëson shkëmbimin e ekspertizës dhe inteligjencës financiare për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit midis anëtarëve të saj. NjIF-ja është e autorizuar, kur ka dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit, të bllokojë ose të ngrijë përkohësisht një transaksion ose një operacion financiar deri në 72 orë dhe të informojë Prokurorinë e Përgjithshme.
- **Agjencia për Administrimin e Aseteve të Sekuestruara dhe Konfiskuara** është përgjegjëse për administrimin e pasurive me origjinë nga krimi dhe për këtë qëllim bashkëpunon me të gjitha institucionet që luajnë rol në sekuestrimin e aseteve. Roli i agjencisë hyn në fuqi pasi merret një vendimi gjyqësor lidhur me një aset të caktuar. Deri më sot agjencia ka pasur përvojë të kufizuar në lidhje me krimin kompjuerik dhe nuk i është kërkuar - për shkak të natyrës së rolit të saj - të angazhohet në bashkëpunimin ndërkombëtar.
- **Ministria e Drejtësisë** është autoriteti qendror i caktuar për asistencë të ndërsjellë juridike në çështjet penale. Ajo komunikon drejtpërdrejt me homologët dhe kryen rolin e saj në lidhje me konventat e Këshillit të Evropës, përfshi Konventat e Budapestit, Strasburgut dhe Varshavës, konventat e OKB-së dhe angazhohet në bashkëpunimin ndërkombëtar të bazuar në parimin e reciprocitetit. Përgjegjësitë e saja primare përfshijnë marrjen, përkthimin dhe transmetimin e kërkesave për ALN (siç është treguar më lart, edhe prokurorët mund të marrin dhe të transmetojnë kërkesat drejtpërsëdrejti me kusht që të jetë informuar autoriteti qendror). Autoriteti qendror i Shqipërisë raporton se përkthimi dhe përpunimi i kërkesave për informacione plotësuese shtesë nga shtetet ekzekutuese janë shkaqe të zakonshme të vonesës, siç është përdorimi i kanaleve diplomatike që kërkohet nga disa vende.

2. Masat

2.1 Masat e brendshme/në nivel vendi

Çdo vend ka legjislacion mbi bazën të cilin ai ndjek penalisht shkelësit dhe përmes të cilit autoritetet janë të autorizuar të hetojnë krimin (dhe kriminelët).

Praktika mund të nxjerrë nevojën për marrëveshje më të detajuara për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve gjatë zbatimit të disa masave të veçanta (për shembull mjete të posaçme hetimore, urdhër ngrirjeje, ruajtje të përshpejtuar etj.). Mund të merret në konsideratë një dispozitë e veçantë e protokollit / Marrëveshjes së Mirëkuptimit.

Çështjet e brendshme në vijim do të kërkojnë legjislacion dhe proces të rregullt. Rrjedhimisht, ato duhet të merren parasysh në hetimet që përfshijnë krimin kompjuterik dhe hetimin lidhur me produktet nga këto vepra penale. Në këto kushte, çështjet e mëposhtme duhet të zhvillohen në një mënyrë që parashikohet nga legjislacioni i brendshëm:

- Lëshimi i urdhrave
- Arrestimet
- Ruajtja e përshpejtuar e të dhënave kompjuterike të grumbulluara
- Ruajtja e përshpejtuar dhe zbulimi i pjesshëm i të dhënave të trafikut
- Urdhrat e prodhimit
- Kontrolli dhe sekuestrimi
- Grumbullimi në kohë reale i të dhënave të trafikut
- Përgjimi i të dhënave të përmbajtjes
- Kërkoni raportimin e transaksioneve të dyshimta
- Kërkoni identifikimin / zbulimin e rrugëve të transaksionit
- Kërkoni mbajtjen ose zbulimin e informacionit të transaksionit
- Ndalimi i zbulimit të çdo hetimi në përgjithësi apo hetimi të pastrimit të parave
- Të pezullohen ose të ndalohen përkohësisht transaksionet që janë raportuar si transaksione të dyshimta
- Bashkëngjitja / konfiskimi i llogarive bankare dhe asetëve të tjera (monedha virtuale etj.)
- Masat për ngrirjen e përkohshme të pronës, masat për konfiskimin penal
- Mjetet e hetimit (aksesi në të dhënat e llogarisë bankare, përdorimi i SIMS).

2.2 Masat në nivel mdërkombëtar

Kur bashkëpunojmë me partnerët ndërkombëtarë, pritshmëria e përgjithshme është se kombet do të kenë aprovuar masa të mjaftueshme për të mbështetur marrëveshjet e bëra sipas konventave të Budapestit dhe Varshavës.

Këto konventa u kërkojnë palëve të miratojnë legjislacionin kombëtar që parashikon masa dhe dispozita të veçanta hetimi. Kërkesat për asistencë juridike të ndërsjellë mund të bëhen pastaj sipas konventave në lidhje me masat e mëposhtme:

- Ruajtja e përshpejtuar e të dhënave kompjuterike të memorizuara (neni 29 i Konventës së Budapestit)
- Zbulim i përshpejtuar i të dhënave të ruajtura të trafikut (Neni 30 Konventa e Budapestit)
- Asistencë e ndërsjellë në lidhje me aksesin ndaj të dhënave kompjuterike të memorizuara (neni 31 Konventës së Budapestit)

- Asistencë e ndërsjellë në lidhje me grumbullimin në kohë reale të të dhënave të trafikut (neni 33 i Konventës së Budapestit)
- Asistencë e ndërsjellë në lidhje me përgjimin e të dhënave të përmbajtjes (neni 34 i Konventës së Budapestit)
- Kërkesa për informacion mbi llogaritë bankare (neni 17 i Konventës së Varshavës)
- Kërkesa për informacion mbi transaksionet bankare (neni 18 i Konventës së Varshavës)
- Kërkesat për monitorimin e transaksioneve bankare (neni 19 i Konventës së Varshavës)
- Konfiskimi i instrumenteve / produkteve / pasurisë në vlerën korresponduese (nenet 23 - 26 të Konventës së Varshavës):
 - Ekzekutimi i kërkesave për konfiskim
 - Trajtimi i aseteve të konfiskuara
 - Kushtet për urdhrat e konfiskimit

Kërkesat e përmendura më sipër transmetohen në mënyrën e parashikuar në konventa, neni 25 i Konventës së Budapestit, kur ka një bazë ligjore ekzistuese në fuqi për bashkëpunim ose neni 27 (nëse pranohet nga pala shtetërore), kur nuk ekziston një bazë e tillë, dhe nenet 33 dhe 34 të Konventës së Varshavës, duke iu nënshtruar dispozitave të konfidencialitetit dhe kufizimeve aty ku është e aplikueshme dhe në mungesë të marrëveshjes ekzistuese përkatëse (neni 28 i Konventës së Budapestit dhe neni 43 i Konventës së Varshavës).

Dispozitat të tjera shtesë për bashkëpunimin ndërkombëtar janë:

- Dhënia e informacionit spontan (neni 26 i Konventës së Budapestit, neni 20 i Konventës së Varshavës),
- Aksesit ndërkufitar ndaj të dhënave kompjuterike të memorizuara që janë objekt i lejes, kur të dhënat janë në dispozicion të publikut (neni 32 i Konventës së Budapestit). Kjo është një masë ekstra-territoriale në dispozicion të hetuesve të angazhuar në hetimin e veprës penale në kompetencën e tyre territoriale të kompetencës së zbatueshme në rrethana të caktuara të kufizuara,
- Krijimi i një rrjeti me PK 24/7 (neni 35 i Konventës së Budapestit),
- Shkëmbimi i informacionit ndërmjet NJIF-ve në mënyrë spontane ose sipas kërkesës (neni 26 i Konventës së Varshavës),
- Bashkëpunimi ndërmjet NJIF-ve në lidhje me shtyrjen e transaksioneve të dyshimta (neni 47 Konventa e Varshavës).

3. Bashkëpunimi gjatë hetimeve penale

Krijimi i një Grupi multi-institucional, një Ekipi të Përbashkët Hetimor në rastet ndërkufitare apo ndarja e burimeve kërkon planifikim, shkëmbim informacioni, marrëveshje dhe bashkëpunim. Më poshtë jepen disa nga konsideratat që prokurorët, zyrtarët e lartë të policisë dhe menaxherët e institucioneve do të duhet të marrin në konsideratë në mbështetje të bashkëpunimit institucional gjatë hetimeve penale.

3.1 Hetimi paraprak

- Njoftimi në fazën e hetimit paraprak.
 - Kur bashkëpunimi kërkohet nga dy ose më shumë institucione, sugjerimet paraprake lidhur me llojin e mbështetjes, kohëzgjatjen dhe burimet e domosdoshme duhet të diskutohen sa më shpejt që të jetë e mundur.
 - Parashikimi dhe njoftimi i hershëm i mundësisë së hetimeve që kërkojnë që institucionet të bashkëpunojnë do t'u mundësojë menaxherëve dhe të tjerëve që të planifikojnë përgjigjen ndaj tyre në mënyrë të planifikuar dhe metodike.
 - Mjetet, me anën e të cilave njoftimet dhe kërkesat për hetim paraprak do të jenë konfidenciale, duhet të identifikohen qartë.
 - Prokurorët dhe hetuesit e lartë mund të analizojnë kërkesat për krijimin e një Grupi multi-institucional ose Ekipi të Përbashkët Hetimor dhe të venë në zbatim planet e nevojshme. Hollësi të tjera përshkruhen më poshtë në këtë dokument.

3.2 Nisja e hetimit

- Si jepet njoftimi?
- Në cilën fazë duhet dhënë njoftimi?
- Çfarë duhet të përmbajë njoftimi?
 - Emrat e palëve
 - Gjykata, nëse ka, ku ka nisur apo do të nisë procedimi
 - Natyra e veprimit / procedimit
 - Faktet e supozuara që shërbejnë si bazë për veprimin / procedimit
 - Data e parashikuar për nisjen e veprimeve / procedurave
- A ka kërkesë që palët të mbajnë konfidenciale njoftimet në lidhje me nisjen e hetimeve nëse kërkohet?
- Bashkëpunimi në lidhje me masat e caktuara (shih Masat më poshtë).

3.3 Bashkëpunimi në lidhje me shkëmbimin e informacionit

Shih Shkëmbimin e Informacionit të Përpunuar Kriminal, Informacionit të Thjeshtë dhe Provave më poshtë.

4. Shkëmbimi i informacionit të përpunuar kriminal, informacionit të thjeshtë dhe provave

Agjencitë e zbatimit të ligjit, organizatat e zbulimit dhe qeveritë e njohin nevojën për të bashkëpunuar, ndarë dhe shkëmbyer informacion. Shkëmbimi efikas i informacionit të përpunuar kriminal, informacionit të thjeshtë dhe provave kërkon proces, besim dhe siguri.

Duke marrë parasysh kërkesat e mëposhtme, prokurorët, institucionet e zbatimit të ligjit dhe NjIF-i do të sigurojnë një sistem që balancon kërkesat ligjore dhe konsideratat e privatësisë, si dhe që identifikon saktësisht se si mund të përdoren informacioni i thjeshtë, informacioni i përpunuar kriminal dhe provat në proceset përkatëse.

- Parakushtet për shkëmbimin e informacionit të përpunuar kriminal, informacionit të thjeshtë dhe provave
- Procedura për kërkimin e informacionit të përpunuar kriminal, informacionit të thjeshtë dhe provave:
 - Si do të bëhen, pranohen dhe përpunohen kërkesat për informacion nga secila palë?
 - Cilët janë personat brenda çdo institucioni ku do të dërgohen kërkesat?
- Konfidencialiteti i kërkesave
- Kufizime ndaj konfidencialitetit të kërkesave
- Sanksionet për shkeljen e konfidencialitetit të kërkesave
- Informacioni spontan
- Afati kohor maksimal për përpunimin e kërkesave:
 - Përjashtime
 - Kërkesa urgjente
 - Asnjë përjashtim për ditë festash / fundjava / orët e punës
- Mbrojtja e të dhënave
- Konfidencialiteti i informacionit - niveli i klasifikimit
 - Kërkesa që palëve të mos u jepet asnjë njoftim (p.sh. të mos njoftohet mbajtësi i llogarisë bankare lidhur me ngrirjen e llogarive bankare)
 - Masat e sigurisë që duhen zbatuar
 - Sigurimi fizik i ambienteve
 - Sigurimi i sistemeve të TI
 - Sanksionet për zbulim të paautorizuar të informacionit të shkëmbyer
 - Përjashtime nga konfidencialiteti:
 - Kur zbulimi kërkohet me ligj
 - Kur ka leje për zbulim informacioni
 - Udhëzime e duhura që u jepen pikave të kontaktit / stafit tjetër të përfshirë në lidhje me kërkesat e konfidencialitetit
- Shkëmbimi i kushtëzuar i provave
- integriteti i të dhënave, informacionit të përpunuar kriminal dhe provave të shkëmbyera:
 - Pronësia
 - Proceset për ruajtjen e integritetit / zinxhirit të ruajtjes
 - Vënia në dispozicion e zyrtarëve për të dëshmuar vërtetësinë e të dhënave në gjykatë
- Mjetet përmes të cilave do të ndahen të dhënat elektronike (reja kompjuterike "cloud" / disqet fizike, etj.).

5. Grupe multi-institucionale

Krijimi i një Grupi multi-institucional për një hetim penal mund të kërkohej disa arsye, të cilat përfshijnë ndarjen e burimeve, madhësinë e operacionit, kërkesën ligjore për përfshirjen e institucioneve të ndryshme, përsheptimin dhe shumë nevoja të tjera.

Gjatë krijimit të një Grupi multi-institucional ka disa çështje që duhet të merren parasysh, të cilat përfshijnë leadershipin, burimet, përgjegjësinë dhe kuadrin ligjor. Ky paketë udhëzimesh parashtron disa konsiderata që duhen ndërmarrë gjatë krijimit të një Grupi të tillë multi-institucional dhe duhet të rishikohet gjatë gjithë hetimit. Legjislacioni kombëtar do të ketë prioritet mbi rekomandimet e detajuara më poshtë.

5.1 Ngritja e Grupit multi-institucional

Gjatë ngritjes së një Grupi multi-institucional, duhet të merren në konsideratë dhe të regjistrohen për rishikim të mëvonshëm:

- Grup multi-institucional i përkohshëm ose i përhershëm:
 - Nëse është i përkohshëm, afati i Grupit multi-institucional
- Proceset e ndërmarra për identifikimin dhe hartimin e institucioneve të përfshira
- Zhvillimi i strukturës:
 - Udhëheqja dhe autoriteti për Grupin multi-institucional
 - Planifikimi i burimeve dhe sigurimi i menaxhimit të strukturës
 - Dispozitat për ndryshime në leadership apo strukturë
- Nivelet e Grupit multi-institucional:
 - Format ekzistuese të praktikës dhe koordinimit
 - Lidhjet virtuale ndërmjet institucioneve:
 - Qendra e institucioneve të bashkërenduara / që punojnë sëbashku

5.2 Personel i Grupit multi-institucional

Pasi të jetë marrë vendimi për krijimin e një Grupi multi-institucional, burimet njerëzore duhet të konsiderohen dhe të aprovohen nga menaxherët përkatës të institucioneve të përfshira në krijimin e një grupi të tillë. Burimet duhet të monitorohen vazhdimisht nga administrata e strukturës. Më poshtë jepet udhëzime në lidhje me këto konsiderata:

Caktimi i personelit nga institucionet:

- Numri i personelit
- Detyrat e personelit
- Kohëzgjatja e emërimit
- Programi i personelit.

Personeli specifik që do të caktohet:

- Pozicionet e bashkëpunëtorëve ndërinstitucional (caktimi i individit të një institucioni për të bashkëpunuar me / ndërmjet institucioneve dhe departamenteve)
- Pozicionet e ndërlidhjes (personi i punësuar nga një institucion i caktuar për të punuar me një institucion tjetër)

- Detajet e personelit (specialist ose profesionist i punësuar për të kryer detyra për një institucion tjetër).

5.3 Vendimmarrja Strategjike

Puna efektive e një Grupi multi-institucional efikas do të mbështetet në leadership të qartë, vendimmarrje transparente dhe planifikim të mirë strategjik. Duke përcaktuar një proces strategjik vendimmarrës në fillim të një grupi të tillë, proceset bashkëpunuese duhet të jenë shumë më efektive. Më poshtë jepen disa konsiderata:

- Institucionet drejtuese
- Rolet e veçanta
- Zgjedhja e juridiksioneve
- Zgjedhja e forumeve
 - Ndërhyrje të koordinuara:
 - Në lidhje me informacionin e thjeshtë / informacionin e përpunuar kriminal/ informatat ekzistuese tashmë
 - Lidhur me kryerjen e arrestimeve, kontrolleve dhe sekuestimeve
 - Në lidhje me ngrirjen e aseteve.

5.4 Bashkëpunimi i Teknologjive

- Dakordësim për krijimin e bazës së të dhënave në kohë reale
- Kërkesë që institucionet të mbajnë dhe përditësojnë baza të dhënash të ndërlidhura në kohë reale për të lejuar:
 - Ndarjen e informacionit ndërmjet institucioneve në kohë reale
 - Vendimmarrjen në kohë reale ndërmjet institucioneve
 - Komunikimin në kohë reale ndërmjet institucioneve
 - Masat për mbrojtjen e të dhënave
 - Standardet e sigurisë / kodifikimit.
- Akses në databazën e informacionit që do të përdoret në fazat e hetimeve paraprake dhe hetimit.

5.5 Analizimi dhe Raportimi

Matja e arritjeve dhe zhvillimi i procedurave është një kërkesë e vazhdueshme në zhvillimin e çdo procesi hetimor. Kjo mundëson identifikimin e praktikave më të mira, bllokimet që duhet hequr dhe rreziqet që duhen zbutur. Disa konsiderata që mund të arrijnë më së miri këtë objektiv jepen më poshtë:

Mbajtja e regjistrimeve

- Periudha e detyrueshme e mbajtjes
- Mënyra e mbajtjes
- Lloji i të dhënave që do të ruhen nga institucionet

Përgjegjshmëria:

- Matja e arritjes së rezultateve afatshkurtra / afatgjata
- Mjetet me të cilat duhet të gjurmohet progresi

Takimet / Raportet:

- Zhvillimi i planit-orareve për takimet

- Takime vjetore dhe takime të jashtëzakonshme
- Njoftim për takime
- Rendi i ditës për takimet
- Rezultatet e takimeve.

Analizat e kërkuara:

- Rishikimi i aktiviteteve të zbatimit të ligjit në vazhdim
- Analiza e efektivitetit të koordinimit
- Aktivitetet e ardhshme për zbatimin e ligjit
- Analiza e statistikave për identifikimin e problemeve në bashkëpunim etj.
- Analiza e riskut
- Analiza e planeve të veprimit të punës / programeve të punës të çdo institucioni.

5.6 Puna kërkimore

-
- Shkëmbimi i informacionit mbi aktivitetet e ardhshme kërkimore me interes të ndërsjellë
- Ftoni njëri-tjetrin në takimet përkatëse të ekspertëve dhe bashkëpunoni në aktivitetet kërkimore
- Shkëmbimi i informacionit për çështjet që kanë të bëjnë me zbatimin e ligjit.

5.7 Trajnim i përbashkët

Trajnimi është një metodë për ndarjen e praktikave më të mira dhe sqarimin e disa keqkuptimeve në organizata të ndryshme. Ai është një pjesë vitale e planifikimit paraprak për Grupet multi-institucionale. Lista e mëposhtme është një standard bazë asaj që duhet të konsiderohet nga aktivitetet trajnuese gjatë organizimit të tyre:

- Ndarja e materialeve ekzistuese të trajnimit
- Hartimi dhe vlerësimi i aktiviteteve trajnuese / seminareve / mjeteve / metodologjive për institucione të ndryshme
- Zhvillimi i materialeve të përbashkëta të trajnimit
- Procedurat për mbajtjen e trajnimeve të përbashkëta
- Ftesa e njëri-tjetrit në aktivitete trajnuese / seminare praktike
- Shpeshësia e trajnimit
- Financimi për trajnime të përbashkëta
- Përgjegjësia për trajnime të përbashkëta.

5.8 Bashkëpunimi joformal

- Autorizimi i mjeteve joformale / inovative të bashkëpunimit
- Eksploroni të gjitha rrugëve ligjore / mundësive për bashkëpunim
- Vazhdimi i respektimit të rregullave për të dhënat personale, privatësinë dhe rregullat e tjera
- Shqyrtimi i asaj vlerë që një gjykatë mund të shikojë si bashkëpunim joformal dhe për këtë arsye të përjashtojë provat.

5.9 Pikat e kontaktit për Grupet multi-institucionale

- Përcaktimi i pikave të kontaktit në çdo institucion
- Mjetet me të cilat mund të kontaktohet pikat e kontaktit
 - Çështjet urgjente

- Çështjet jo urgjente
- Pikat e përhershme të kontaktit të përbëra nga personel me lejen e duhur të sigurisë sipas një standardi të miratuar
- Stafi i pikave të caktuara të kontakteve të këtyre autoritet të plotë për t'iu përgjigjur rasteve (nuk kërkohen autorizime të mëtejshme).

5.1 Bërja publike

- Kufizime në dhënien e deklaratave për shtyp në lidhje me aktivitetet e Grupeve multi-institucionale pa pëlqimin e të gjitha palëve.

5.2 Përfundimi i Grupeve shumë-institucionale

- A mundet një agjenci t'u japë fund në mënyrë të njëanshme grupeve shumë-institucionale?
- Në cilat rrethana mund t'u jepet fund Grupeve shumë-institucionale?
- Cili është efekti i ndërprerjes mbi detyrimet ndaj palëve?
- Cili është efekti i ndërprerjes ndaj bashkëpunimit / informacionit të shkëmbyer më parë?
- Si duhet të jepet njoftimi i përfundimit?

5.3 Shpenzimet

- Kush i mbulon shpenzimet që lindin gjatë funksionimit të grupeve shumë-institucionale?

6. Bashkëpunimi ndërmjet sektorit publik dhe privat

Hetimi i krimit kompjuterik dhe / ose vënia në shënjestër e produkteve nga krimi online dhe pastrimi i parave kërkon bashkëpunim të fuqishëm dhe efikas të sektorit publik dhe atij privat. Ky bashkëpunim do të bazohet në masat kombëtare dhe ndërkombëtare (të specifikuara diku tjetër në këtë dokument), të cilat duhet të miratohen brenda secilit vend.

Zbatimi me efektivitet i këtyre ligjeve dhe traktateve mbështetet në protokollet përkatëse dhe procedurat standarde të punës për të cilat bihet dakord dhe zbatohen nga sektorët publikë dhe privatë.

Kërkesat për të mbështetur bashkëpunimin midis sektorit publik dhe atij privat duhet të konsiderojnë pikat e mëposhtme:

- Zhvillimin e një sistemi përmes të cilit institucioni duhur do të marrë të dhëna nga personat e sektorit privat nga të cilët kanë mandat ligjor për të rregulluar / kërkuar bashkëpunim / informacion:
 - Ndarja e roleve në bazë të efikasitetit dhe mandateve ligjore
 - Bëjeni atë ta ketë varësinë mbi bazën çështje ose rast pas rasti
- Mekanizmat me të cilat do të kryhet bashkëpunimi me sektorin privat
- Krijimi i grupeve multi-institucionale të përhershme me organe të ndryshme të sektorit privat (p.sh. CERT-të, ccTLD-të, Kompanitë e Internetit, etj.).

Suksesi i bashkëpunimit midis sektorit publik dhe atij privat shpesh bazohet në Marrëveshje Mirëkuptimi të përmbledhura dhe të shkurtra. Është e rëndësishme që këto dokumente të rishikohen rregullisht dhe të përditësohen sipas nevojës.

Protokollet e bashkëpunimit midis sektorit publik dhe privat janë një çështje e veçantë.²

² Shih Udhëzimet e Këshillit të Evropës për bashkëpunim ndërmjet oficerëve të zbatimit të ligjit dhe ofruesve të shërbimeve të internetit kundër krimit kompjuterik, 2008:
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016802fa3ba>
I disponueshëm në shqip: <https://rm.coe.int/16802fe152>

7. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Detyrimi për të bashkëpunuar (qoftë nëpërmjet shkëmbimit të informacionit ose asistencës së ndërsjellë juridike) rrjedh nga traktatet ndërkombëtare, përfshi Konventën e Këshillit të Evropës për Asistencë të Ndërsjellë në Çështjet Penale dhe Protokollet, Konventën e Budapestit për Krimin Kompjuterik (ETS Nr.185), Konventën e Strasburgut mbi Pastrimin, Kontrollin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e të Ardhurave nga Krimi (ETS Nr.141) dhe Konventën e Varshavës për Pastrimin, Kontrollin, Sekuestrimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Veprave Penale dhe Konventën mbi Financimin e Terrorizmit (CETS Nr.198). Megjithatë, disa nga sfidat praktike që dalin nga ky bashkëpunim janë adresuar nga komitetet ose mekanizmat e tjerë monitorues të krijuar për këtë qëllim (shih Komitetet e Këshillit të Evropës më poshtë). Kur është e përshtatshme, duhet të merren parasysh edhe kornizat përkatëse të bashkëpunimit dypalësh ose rajonal, si një bazë e mundshme për bashkëpunim.

Megjithëse përgjegjësitë për asistencën e ndërsjellë juridike mund të ndahen ndërmjet gjyqtarëve, prokurorëve (hartimi dhe ekzekutimi i kërkesave) dhe autoriteteve qendrore (pasi ndër të tjera përkthimi, transmetimi, pranimi dhe ekzekutimi i kërkesave), është gjithashtu e rëndësishme të jemi të vetëdijshëm për kanale të tjera bashkëpunimi (dhe kufizimet e tyre) në nivel të policisë. Në të gjitha rastet, por veçanërisht në rastet komplekse, metoda më e efektshme e mbledhjes së informacionit duhet të identifikohet nga personat e përfshirë që në fillim, me qëllim që të shmanget përdorimi i njëkohshëm i më shumë se një kanali për të njëjtat qëllime, pasi kjo mund të çojë në dublikimin e kërkesave.

7.1 Ekipet e përbashkëta hetimore

Baza ligjore ndërkombëtare e zbatueshme për ekipet e përbashkëta të hetimit (EPH) gjendet në Nenin 20, Protokollin i Dytë i vitit 2001, në Konventën e Këshillit të Evropës mbi Asistencën e Ndërsjellë në Çështjet Penale. Neni 27 i Konventës së Bashkëpunimit Policor për Evropën Juglindore të vitit 2006 siguron një bazë ligjore shtesë dhe, gjithashtu, secila nga konventat e Kombeve të Bashkuara mbi krimin e organizuar (Konventa e Palermos) dhe korrupsionin (UNCAC) përbëjnë bazë për krijimin e ekipeve të përbashkëta dhe organeve të përbashkëta hetimore. Në të gjitha rastet duhet të identifikohen bazat e duhura ligjore sa më shpejtë që të jetë e mundur.

Nëse ofrohen për t'u bërë pjesë e një EPH-je nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian (BE-së), informacione të dobishme mbi praktikën e BE-së për EPH-të janë në dispozicion në faqet e internetit të Europol³ dhe EUROJUST⁴.

Në BE, një EPH krijohet për një periudhë të caktuar dhe për një qëllim specifik, bazuar në një marrëveshje midis dy ose më shumë autoriteteve kompetente në shtetet anëtare. Autoritetet kompetente nga vende jashtë BE-së mund të marrin pjesë në një EPH në varësi nga marrëveshja e të gjitha palëve të tjera pjesëmarrëse dhe ekzistenca e bazës kryesore të duhur ligjore.

Në përgjithësi, çdo EPH krijohet për të hetuar një rast specifik. Kur hetimi përfundon, EPH-ja mbyllet, pra nuk ka EPH të përhershme ose të vazhdueshme. Kushtet në përputhje me të cilat operon një EPH variojnë disi nga rasti në rast, megjithatë, kushtet zakonisht bazohen në një marrëveshje model të bashkëngjitur Rezolutës së Këshillit të datës 26 shkurt 2010 "Për një Marrëveshje Model për ngritjen e

³ <https://www.europol.europa.eu/activities-services/services-support/joint-investigation-teams>

⁴ <http://www.eurojust.europa.eu/doclibrary/JITs/joint-investigation-teams/Pages/jits-framework.aspx>

një Ekipi të Përbashkët Hetimor (EPH) (2010 / C 70/01), e cila inkurajon autoritetet kompetente në Shtetet Anëtare "të pajtohen me modalitetet për ekipin e përbashkët hetimor".

Duke qenë se shumica e shteteve anëtare të BE-së kanë nënshkruar dhe ratifikuar Konventat e Budapestit dhe Varshavës, pritshmëria është që anëtarët e EPH-së të jenë në gjendje të zbatojnë dispozitat e këtyre traktateve.

Krijimi i një EPH-je

Gjatë krijimit të një EPH-je është me vend të merren parasysh konsideratat e mëposhtme:

- Njoftimi për krijimin
- Struktura/lidershipi
- Protokollet Standarde Operacionale
 - Procedurat Standarde të Punës me institucionet financiare për të siguruar që, aty ku është e nevojshme, rrjedha e transfertave të parave të paligjshme të mund shtyhet deri sa të mund shfrytëzohet informacioni i përpunuar kriminal i nevojshëm dhe / ose instrumentet e mëtejshme ligjore,
 - Marrëveshje ku secili nga institucionet përkatëse do të kontaktojë një përfaqësues të emëruar në institucionet përkatëse të partnerit për të përshpejtuar kërkesat
- Kryerja e hetimeve
 - Respektimi i zinxhirit të ruajtjes së provave.
 - Nisja e duhur e hetimeve
 - Lista aktuale e kontakteve të departamenteve të Policisë që janë në shërbim
 - Mbajtja e listave të përditësuara të kontakteve të institucioneve financiare nga ana e institucioneve përkatëse
- Fondet e nevojshme (megjithëse disa financime mund të sigurohen nga burimet e BE-së)
- Burimet dhe rekrutimi i stafit
 - Lidershipi i duhur
 - t e duhura, përfshirë nivelet e aftësive.
 - Ndarja e duhur e roleve dhe përgjegjësi
- Marrëveshje e përbashkët lidhur me faktin se në cilën fazë do të mbyllet një EPH
- Bashkëpunimi pas përfundimit të një EPH-je.

7.2 Standardet ndërkombëtare

Dispozitat përkatëse të Konventës së Varshavës (të zbatueshme për hetimet financiare, asistencën e ndërsjellë juridike dhe bashkëpunimin e NJIF-së), Konventa e Budapestit (e zbatueshme për hetimet / hetimet për krimin në internet lidhur me marrjen e provave elektronike) dhe Rekomandimet 40 të Task Forcës së Veprimtarisë Financiare (TFVF) (të zbatueshme për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave, veprave penale mëmë që lidhen me to dhe financimin e terrorizmit) duhet të merren parasysh kur fillohet një kurs bashkëpunimi ndërkombëtar. Dispozitat më të rëndësishme të këtyre instrumenteve janë renditur më poshtë.

Instrumentet ligjore të BE-së

Instrumentet ligjore të BE-së janë të zbatueshme brenda Bashkimit Evropian. Mund të jetë e dobishme të kuptohen standardet, metodat dhe praktikat e instrumenteve më të rëndësishëm që shënjestrojnë produktet e veprës penale dhe krimin kompjuterik në fushat e asistencës së ndërsjellë juridike, kur bashkëpunojmë me një shtet anëtar të BE-së.

- Direktiva 2014/42 / BE "Për ngrirjen dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të veprës penale në Bashkimin Evropian";
- Vendimi Kuadër 2001/500 / ANJ (*Analiza e Rreziqeve në Punë*) "Për pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen, sekuestrimin dhe konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të veprës penale;
- Vendimi Kuadër 2005/212 / ANJ "Për konfiskimin e të ardhurave, instrumenteve dhe pasurisë së lidhur me krimin;
- Parimi i njohjes së ndërsjellë, në krahasim me asistencën e ndërsjellë, ka hyrë në BE:
 - Vendimi Kuadër 2003/577 / ANJ "Për ekzekutimin e urdhrave të ngrirjes"
 - Vendimi Kuadër 2006/783 / ANJ :Për urdhrat e konfiskimit"
 - Vendimi i Këshillit 2007/845 / ANJ miratoi detyrimin për të ngritur Zyren e Rimëkëmbjes së Aseteve (ZRA)
 - Direktiva 2013/40 / BE "Për sulmet ndaj sistemit të informacionit (24/7)"
 - Direktiva 2014/41 / BE "Për urdhrin evropian të hetimeve në çështjet penale.

Parimet e përgjithshme të zbatueshme për bashkëpunimin ndërkombëtar

- Konventa e Varshavës, neni 15
 - Palët bashkëpunojnë reciprokisht me njëra-tjetrën në shkallën më të gjerë të mundshme për qëllimet e hetimeve dhe procedimeve që synojnë konfiskimin e instrumenteve dhe produkteve të veprës penale.
 - Palët duhet të respektojnë kërkesat për konfiskimin e objekteve specifike të pronës që përfaqësojnë produkte ose instrumente të veprës penale, si dhe për konfiskimin e produkteve të veprës penale sipas një rregulli për të paguar një shumë parash që korrespondon me vlerën e të ardhurave, si dhe për asistencën hetimore dhe masat e përkohshme lidhur me secilën formë të konfiskimit.
- Konventa e Budapestit, neni 23 dhe 25
 - Palët reciprokisht i ofrojnë njëra-tjetrës asistencën reciproke më të gjerë të mundshme për qëllimet e hetimeve ose procedimeve për veprat penale që lidhen me të dhënat dhe sistemet kompjuterike, ose për mbledhjen e provave në formë elektronike të një vepre penale.
- TFVF, Rekomandimi 37
 - Vendet duhet të sigurojnë gamë më të gjerë të mundshme të asistencës së ndërsjellë juridike në lidhje me pastrimin e parave, veprat shoqëruese mëmë dhe hetimet për financimin e terrorizmit, ndjekjet penale dhe procedurat përkatëse.

Komunikimi dhe transmetimi i kërkesave

Palët në Konventat e Varshavës dhe Budapestit duhet të caktojnë autoritetet qendrore që komunikojnë drejtpërdrejt me njëra-tjetrën (Konventa e Varshavës - nenet 33 dhe 34; Konventa e Budapestit

- neni 25 zbatohet kur ka një bazë ekzistuese për bashkëpunim, dhe neni 27 mund të zbatohet nëse pranohet nga pala kur nuk ka një marrëveshje e tillë ekzistuese ose autoritet qendrore të përcaktuar). Sidoqoftë,
- Konventa e Varshavës, neni 34, parashikon që kërkesat urgjente mund të transmetohen drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve gjyqësore, përfshirë prokurorët, me një kopje që do të dërgohet nëpërmjet autoriteteve qendrore ose nëpërmjet INTERPOL-it.
- Konventa e Varshavës, neni 34/5 parashikon që kërkesat jo-shtrënguese (d.m.th. kur ekzekutimi i një kërkesë nuk kërkon përdorimin e një mase shtrënguese) mund të transmetohet drejtpërdrejt ndërmjet autoriteteve kompetente.

- Konventa e Varshavës, neni 34/6 parashikon mundësinë e shkëmbimit të drejtpërdrejtë të projekt-kërkesave për të lehtësuar bashkëpunimin para se të bëhet një kërkesë formale.
- Konventa e Budapestit, nenet 29-31 parashikojnë rastin e kërkesave që duhet të trajtohen në mënyrë të përsheptuar.
- Transmetimi përmes INTERPOL-it është i disponueshëm për të gjitha palët në Konventën e Këshillit të Evropës "Për asistencën e ndërsjellë në çështjet penale.
- Neni 27/9 parashikon një dispozitë të ngjashme (e zbatueshme nëse pranohet nga një palë dhe nëse nuk mbulohet nga një marrëveshje ekzistuese).

Masat e përkohshme

- Konventa e Varshavës, nenet 21-22
 - Palët marrin masa të përkohshme, të tilla si ngrirja apo sekuestrimi, për të parandaluar çdo veprim që ka të bëjë me transferimin ose asgjësimin e pronës objekt i konfiskimit dhe të sigurojë në mënyrë spontane të gjitha informacionet e duhura për ekzekutimin e një mase të tillë të përkohshme.
- Konventa e Budapestit, nenet 29-30 parashikojnë masat e mëposhtme:
 - Ruajtja e përsheptuar e të dhënave kompjuterike të depozituara
 - Shpalosja e përsheptuar e të dhënave të ruajtura të trafikut.
- TFVF, Rekomandimi 38⁵
 - Vendet duhet të kenë autoritetin për të ndërmarrë veprime të shpejta në përgjigje të kërkesave të shteteve të huaja për të identifikuar, ngrirë, sekuestruar dhe konfiskuar pronën e pastruar, produktet nga pastrimi i parave, veprat penale mëmë dhe financimin e terrorizmit, instrumenteve ose pasuri në vlerën korresponduese.

Asistenca hetimore

- Konventa e Varshavës, nenet 16-19
 - Palët ndihmojnë njëra-tjetrën në identifikimin dhe gjurmimin e instrumenteve, produkteve të veprës penale dhe pasurive të tjera objekt i konfiskimit, që përfshijnë sigurimin e provave në lidhje me ekzistencën, vendndodhjen ose lëvizjen, natyrën, statusin ligjor ose vlerën e pronës së lartpërmendur.
 - Asistencë e tillë përfshin edhe kërkesat për informacion mbi llogaritë bankare, transaksionet bankare dhe monitorimin e transaksioneve bankare)
- Konventa e Budapestit, Nenet 31-34 - Asistenca e ndërsjellë në lidhje me kompetencat hetimore:
 - Aksesimi /sekuestrimi ose në mënyrë të ngjashme sigurimi/zbulimi i të dhënave kompjuterike të memorizuara,
 - Asistencë e ndërsjellë në lidhje me grumbullimin në kohë reale të të dhënave të trafikut,
 - Asistencë e ndërsjellë në lidhje me përgjimin e të dhënave të përmbajtjes që i nënshtrohen ligjit të brendshëm të vendit.
- TFVF, Rekomandimi 37
 - Vendet duhet të sigurojnë që të gjitha kompetencat dhe teknikat hetimore në dispozicion të autoriteteve të tyre kompetente, përfshirë ato që kanë të bëjnë me prodhimin, kontrollin dhe sekuestrimin e informacioneve, dokumenteve ose dëshmimeve (përfshirë të dhënat financiare)

⁵ Shih gjithashtu Shënimin Interpretues për Rekomandimin 38 të TFVF-së.

nga institucionet financiare ose personat e tjerë dhe marrjen e deklaratave të dëshmitarëve, janë gjithashtu në dispozicion për t'u përdorur në përgjigje të kërkesave për ALN-në.

Konfiskimi

- Konventa e Varshavës, nenet 23-25
 - Palëve u kërkohet të zbatojnë një urdhër konfiskimi ose të paraqesin kërkesën pranë autoriteteve të tyre kompetente me qëllim marrjen e urdhrit të konfiskimit dhe zbatimin e tij.
 - Kjo përfshin një kërkesë për të paguar një shumë parash që korrespondon me vlerën e të ardhurave të veprës penale ose konfiskimin e objektit specifik të pronës (konfiskimi i vlerës nuk është ende i disponueshëm në Shqipëri, megjithatë një ndryshim i Kodit Penal pritet ta sjellë këtë në fuqi).
 - Neni 23/5 parashikon ekzekutimin e një kërkesë gjyqësore për masa ekuivalente me konfiskimin që çojnë në heqjen e pasurisë, të cilat nuk janë sanksione penale (konfiskim i bazuar në mosdënim).
 - Neni 25 përcakton rregullat e ndarjes së aseteve: pasuria merret kryesisht nga Pala ekzekutuese, me përjashtim të rasteve kur kërkohet të merret parasysht përparësia e kthimit të saj tek Pala kërkuese, në mënyrë që të kompensojë viktimat ose ta kthejnë pronën tek pronarët e tyre legjitimë.
- Rekomandim 38 i TFVF (shih më lart).

Bashkëpunimi ndërmjet NjIF-ve

- Konventa e Varshavës, Kapitulli V, nenet 46 dhe 47
 - NjIF-të shkëmbejnë, në mënyrë spontane ose mbi bazë kërkesë dhe në përputhje me këtë konventë ose në përputhje me marrëveshjet e mirëkuptimit ekzistuese ose të ardhshme të pajtueshme me këtë Konventë, çdo informacion të aksesueshëm që mund të jetë i duhur për përpunimin ose analizën e informacionit ose, nëse është me vend, me hetimin nga NjIF-ja për informacionet lidhur me transaksionet financiare që lidhen me pastrimin e parave dhe personat fizik ose juridik të përfshirë.
 - Vendet duhet të miratojnë masa për të lejuar ndërmarrjen e një veprimi urgjent nga një NjIF, me kërkesë të një NjIF-je të huaj, për të pezulluar ose ndaluar lejen për një transaksion që po ndodh (shtyrjen e transaksioneve të dyshimta).
- Rekomandimi 40 i TFVF-së
 - NjIF-të duhet të shkëmbejnë informacion me NjIF-të e huaja pavarësisht nga statusi i tyre. Për këtë qëllim, NjIF-të duhet të kenë bazën e duhur ligjore për sigurimin e bashkëpunimit lidhur me pastrimin e parave, veprat penale mëmë të lidhura me to dhe financimin e terrorizmit.
 - NjIF-të duhet të kenë kompetencën për të shkëmbyer: a) të gjitha informatat që mund të marrin nga subjektet raportuese, si dhe informacionet financiare, administrative dhe të zbatimit të ligjit ndaj të cilave ato kanë akses; dhe b) çdo informacion tjetër që ata kanë kompetencën për të marrë ose për të aksesuar në nivel kombëtar, në varësi të parimit të reciprocitetit.

Rrjeti 24/7

- Konventa e Budapestit, neni 35
 - Secila palë cakton një pikë kontakti në dispozicion në baza 24/7, në mënyrë që të sigurohet ofrimi i ndihmës së menjëhershme për qëllime të hetimeve ose procedurave për veprat penale

që lidhen me të dhënat dhe sistemet kompjuterike, ose për mbledhjen e provave në formën elektronike të një vepre penale.

- Asistenca përfshin lehtësimin ose, nëse lejohet nga legjislacioni i brendshëm dhe praktika, zbatimin e drejtpërdrejtë të masave të mëposhtme:
 - dhënien e këshillave teknike,
 - ruajtjen e të dhënave në përputhje me nenet 29 dhe 30,
 - mbledhjen e provave, sigurimin e informacionit ligjor,
 - lokalizimin e të dyshuarve.

Metoda të tjera bashkëpunimi

Ngritja e EPH-ve në përputhje me instrumentet e Këshillit të Evropës dhe BE-së është diskutuar më sipër.

Grupet multi-disiplinore të specializuara për hetimin financiar dhe të aseteve:

- TFVF Rekomandimi 30
- Kur është e nevojshme, vendet duhet të përdorin grupet multi-disiplinore, të përhershme ose të përkohshme, të specializuara për hetimet financiare dhe aseteve dhe të sigurojnë, kur është e nevojshme, të bëhen hetime bashkëpunuese me autoritetet kompetente përkatëse të vendeve të tjera.

Informacioni spontan

- Konventa e Varshavës, neni 20 dhe Konventa e Budapestit, neni 26
- Brenda kufijve të legjislacionit të brendshëm dhe pa kërkesë paraprake, palët mund t'i përcjellin palës tjetër informacione të marra në kuadër të hetimeve të tyre, kur e konsiderojnë se zbulimi i këtyre informacioneve mund ta ndihmojë Palën marrëse për të nisur ose kryer hetime ose procedura në lidhje me veprat penale të përcaktuara në përputhje me këtë Konventë ose mund të çojnë në një kërkesë për bashkëpunim nga kjo palë sipas këtij kapitulli.

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet palëve jo-homologe

- TFVF, Rekomandimi 40 dhe Shënimi Interpretues që lidhet me të
- Vendet duhet t'u lejojnë autoriteteve të tyre kompetente që të shkëmbejnë informacione indirekt me palët jo-homologe. Shkëmbimi indirekt i informacionit i referohet informacionit të kërkuar që kalon nga autoriteti i kërkuar nëpërmjet një ose më shumë autoriteteve të vendase ose të huaja para se të merret nga autoriteti kërkuar. Ky shkëmbim informacioni dhe përdorimi i tij mund t'i nënshtrohet autorizimit të një ose më shumë autoriteteve kompetente të vendit të kërkuar.
- Vendet gjithashtu inkurajohen që të lejojnë një shkëmbim të shpejtë dhe konstruktiv të informacionit direkt me palët jo-homologe.

7.3 Vlerësimi i zbatimit të instrumenteve ndërkombëtare

a. Vënia në shënjestër e produkteve të veprës penale

PC-OC

Komiteti i Ekspertëve të Këshillit të Evropës për Funksonimin e Konventave Evropiane në lidhje me Bashkëpunimin për Çështjet Penale (PC-OC) e fokusoi vëmendjen e tij në fushën e vënies në shënjestër të produkteve të veprës penale në vitin 2014. Përgjigjet ndaj pyetësorit PC-OC⁶ treguan, ndër të tjera, se ka ndryshime në zbatimin e dispozitave të konventave të Strasburgut dhe Varshavës, që lidhen me bashkëpunimin ndërkombëtar.

MONEYVAL

Komiteti i Ekspertëve mbi Vlerësimin e Masave kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit - MONEYVAL⁷ është një organ monitorues i Këshillit të Evropës, i cili vlerëson përputhshmërinë me standardet kryesore ndërkombëtare në luftën kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe efektivitetin e zbatimit të tyre, si dhe dhënien e rekomandimeve për autoritetet kombëtare në lidhje me përmirësimet e nevojshme në sistemet e tyre.

Vlerësimet e ndërsjella të MONEYVAL-it po analizojnë përputhshmërinë e vendeve me rekomandimet⁸ TFVF 40 dhe ndjekin praktikën dhe procedurat e përdorura nga TFVF-ja. Rekomandimet TFVF-së janë standarde ndërkombëtare për luftimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe financimin e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë.

Në lidhje me bashkëpunimin ndërinstitucional, rëndësi të veçantë kanë standardet e mëposhtme të TFVF-së: për bashkëpunimin dhe koordinimin kombëtar (Rek 2), për NjIF-in (Rek 29), për përgjegjësitë e autoriteteve të zbatimit të ligjit dhe atyre hetimore (Rek 30) dhe për kompetencat e tyre (Rek 31), dhe për statistikat (Rek 33).

Rekomandimet për bashkëpunimin ndërkombëtar theksojnë, ndër të tjera, nevojën për ratifikimin dhe zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare, përfshirë konventat e Budapestit dhe Varshavës (Rek 36), përcaktojnë kërkesat për asistencë juridike të ndërsjellë (Rek 37), ngrirjen dhe konfiskimin (Rek 38), ekstradimin (Rek 39) dhe për forma të tjera të bashkëpunimit ndërkombëtar (Rek 40).

KoP

Konferenca e Palëve (KoP) në Konventën e Varshavës është një mekanizëm monitorues i Këshillit të Evropës përgjegjës për të siguruar zbatimin e dispozitave të Konventës së Varshavës. KoP-ja publikoi Raportin e parë të Aktiviteteve, që mbulon periudhën 2009 - 2014, në prill 2016.⁹ Shqipëria është Palë në Konventën e Varshavës që nga 1 maji 2008 dhe pajtueshmëria e saj me dispozitat e kësaj konvente u vlerësua në mars të vitit 2011. Raporti i Vlerësimit të KoP-së për Shqipërinë u botua në faqen e internetit të Këshillit të Evropës.¹⁰

a. Krimi kompjuterik

Komiteti i Konventës së Krimit Kompjuterik (T-CY) të Këshillit të Evropës po monitorin zbatimin e Konventës së Budapestit dhe zhvillimin e standardeve dhe shënimeve udhëzuese të tjera. Është e

⁶Pyetësori për përdorimin dhe efikasitetin e instrumenteve të Këshillit të Evropës në lidhje me bashkëpunimin ndërkombëtar në fushën e sekuestrimit dhe konfiskimit të produkteve të veprës penale, përfshirë menaxhimin e mallrave të konfiskuara dhe ndarjen e aseteve. PC-OC Mod (2015) 06Rev4, 19.5.2016. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=0900001680666607>

⁷ http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/moneyval/Countries/MK_en.asp

⁸ http://www.fatf-gafi.org/media/fatf/documents/recommendations/pdfs/FATF_Recommendations.pdf

⁹ http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/cop198/Reports/FirstActivityReport_CETS198.pdf

¹⁰ [http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/cop198/Reports/C198-COP\(2011\)RASS1_Albania.en.pdf](http://www.coe.int/t/dghl/monitoring/cop198/Reports/C198-COP(2011)RASS1_Albania.en.pdf)

dobishme të konsultohen pjesë nga punët e fundit të T-CY-së që lidhen, gjithashtu, me (efikasitetin e) asistencën e ndërsjellë juridike:

- Kërkesat urgjente të T-CY-së: Komete paraprake në lidhje me përgjigjet¹¹.
- Raport vlerësimi i T-CY: Dispozitat e asistencës së ndërsjellë juridike të Konventës së Budapestit për krimin kompjuterik¹².
- Raporti përfundimtar i Grupit të Provave nga Reja Kompjuterike (CPG) të T-CY-së për aksesin e drejtësisë penale në provat elektronike në renë kompjuterike (cloud): Rekomandimet për t'u konsideruar nga T-CY¹³.
- Shënimi udhëzues i T-CY nr. 10 për urdhrat e prodhimit: në këtë shënim T-CY adresoi, mes të tjerash, situatën ku abonenti e kishte bazën në të njëjtin vend si pala kërkuese dhe të dhënat e abonentit kërkohen nga një palë që ofron shërbime brenda vendit. Shënimi jep udhëzime për nenin 18, i cili i lejon këto kërkesa - dhe T-CY dha më shumë qartësi në kuptimin e "ofrimit të shërbimeve" ose territorin e një pale.

Në raportin e vlerësimit të dhjetorit 2014, T-CY¹⁴ miratoi një sërë rekomandimesh të hartuara për të përmirësuar efikasitetin dhe efektivitetin e procesit të asistencës e ndërsjellë ligjore (ALN) në lidhje me hetimin e krimit kompjuterik dhe marrjen e provave elektronike. Rekomandimet mbështesin një përdorim më efektiv të dispozitave ekzistuese të Konventës së Budapestit dhe marrëveshjeve të tjera, ato janë të ndara në tri pjesë që përbëhen së pari nga rekomandimet 1-15 që u drejtohen Palëve (përfshirë *ndër të tjera* (1) zbatimin e plotë të kompetencave ruajtëse, (3 dhe 4) alokimin e stafit më të trajnuar në procesin e ALN-së, (5) fuqizimin e rolit dhe kapacitetit të pikës së kontaktit 24/7, (8) vendosjen e procedurave të emergjencës), së dyti rekomandimet 16-18 në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve për Zyrën e Programit të Krimit Kompjuterik të Këshillit të Evropës (C-PROC) dhe propozojnë, gjithashtu, zgjidhje shtesë¹⁵, në rekomandimet 19-24 për përfshirjen e mundshme në një protokoll të mundshëm të Konventës së dispozitave që lejojnë (19) zbulimin e përshtetshëm të informacionit në lidhje me abonentin (20) mundësinë e urdhrave ndërkombëtar të prodhimit, (21) bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet autoriteteve gjyqësore, (22) trajtimin e praktikës për marrjes direkt të informacionit nga ofruesit e shërbimeve të huaja (23) hetime të përbashkëta dhe / ose ekipe të përbashkëta hetimore midis Palëve, (24) duke lejuar pranimin e kërkesave në gjuhën angleze.

Dukshëm, CEG në raportin dhe rekomandimet e veta në lidhje me aksesin e drejtësisë penale ndaj dëshmive elektronike në renë kompjuterike (cloud), arriti në përfundimin se ndihma e ndërsjellë ligjore mbetet mjeti kryesor për të marrë dëshmi elektronike nga juridiksionet e huaja për përdorim në procedimet e brendshme penale. Kjo është veçanërisht e vërtetë për transmetimin dhe të dhënat e përmbajtjes. Ai gjithashtu theksoi se të dhënat e abonentit, të cilat për nga natyra e tyre janë më pak intensive nga pikëpamja e privatësisë, duhet të merren duke përdorur masa më pak të bezdisshme dhe më të lehta siç është urdhri i prodhimit. Këtu, raporti këshillon lidhur me përdorimin e nenit 18 (urdhrrat e brendshme të prodhimit) të Konventës së Budapestit me qëllim të marrjes së informacionit të abonentit nga ofruesit multinacional të shërbimeve që veprojnë në territorin e një shteti që ka juridiksion mbi veprën në hetim, duke përjashtuar kështu nevojë për një kërkesë ALN për vendin ku

¹¹ T-CY (2016) 13, 25.7.2016: Kërkesa emergjente për zbulimin e menjëhershëm të të dhënave të ruajtura në një juridiksion tjetër nëpërmjet kanaleve të ndihmës së ndërsjellë juridike ose përmes kërkesave të drejtpërdrejta për ofruesit e shërbimeve: Përgatitja e përgjigjeve: <https://rm.coe.int/16806ab6ab>

¹² T-CY(2013)17rev, 3 Dhjetor 2014: <http://www.coe.int/en/web/cybercrime/t-cy-reports>
<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016802e726c>

¹³ T-CY (2016)5, 16 shtator 2016.

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016806a495e>

¹⁴ Shih faqet 123 to 127, <https://rm.coe.int/16802e726c>

¹⁵ Shih faqet 125 - 127, <https://rm.coe.int/16802e726c>

është vendosur selia e ofruesit të shërbimit – Shënimi udhëzues nr. 10 për përdorimin e urdhrave të prodhimit për marrjen e informacionit mbi abonentin në këto rrethana u miratua nga T-CY¹⁶.

CEG-ja propozoi të konsiderohet gjithashtu hartimi i një protokollit shtesë për të adresuar disa sfida ekzistuese, të cilave iu referuam më lart, përfshirë dispozitat për asistencë ligjore të ndërsjellë më efektive (si p.sh. një regjim i thjeshtuar për kërkesat për asistencë ligjore të ndërsjellë për informacione të abonentit; urdhrat e prodhimit ndërkombëtar; bashkëpunim i drejtpërdrejtë midis autoriteteve gjyqësore në kërkesat për asistencë ligjore të ndërsjellë, organizimi i hetimeve të përbashkëta dhe ekipeve të përbashkëta hetimore; pranimin e kërkesave në gjuhën angleze, dëgjimi audio/video i dëshmitarëve, viktimave dhe ekspertëve; procedurat emergjente të ALN-së); dispozita që lejojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë me ofruesit e shërbimeve në juridiksionet e tjera në lidhje me kërkesat për informacion mbi abonentin, kërkesat për ruajtje dhe kërkesat emergjente; një kuadër më të qartë për praktikën ekzistuese të aksesit ndërkufitar ndaj të dhënave; masa më të forta mbrojtëse, përfshirë kërkesat për mbrojtjen e të dhënave.

Kërkesat për ALN-në ndryshojnë, edhe nëse ato bazohen në instrumentet ligjore ndërkombëtare, pasi ato varen nga legjislacioni kombëtar i shtetit dërgues, si dhe nga legjislacioni dhe pritshmëritë praktike të shtetit pritës. Formularët e kërkesave për ALN mund t'i ndihmojnë shtetet deri në një fare mase; prandaj janë bërë disa përpjekje për të zhvilluar shabllone të modeleve.

Komiteti i Këshillit të Evropës PC-OC zhvilloi një formular kërkesë model për ndihmë të ndërsjellë në çështjet penale. Shihni dokumentet nga mbledhja e 69-të (maj 2016): Hartoni formularin e kërkesës model për ALN-në dhe udhëzimet praktike për specialistët.¹⁷

Siç u përmend më sipër, raporti i vlerësimit të T-CY-së: Dispozitat e ndihmës ligjore të ndërsjellë të Konventës së Budapestit për Krimin Kompjuterik (T-CY (2013) 17rev) parashtrojnë Rekomandimin 17, i cili kërkon zhvillimin e standardizuar të formularëve shumë-gjuhësorë për kërkesat e nenit 31.¹⁸

8. Statistikat

Statistikat zyrtare duhet të sigurojnë informacion sasior ose cilësor për të gjitha fushat kryesore të institucioneve qeveritare ose organeve të tjera publike. Kjo përfshin prokurorinë dhe agjencitë e zbatimit të ligjit.

Statistikat duhet t'u sigurojnë vendimmarrësve dhe përdoruesve të tjerë informacion që ata të mund të zhvillojnë njohuritë e tyre rreth temës, të vlerësojnë performancën e agjencive dhe të identifikojnë përmirësimet e strategjive dhe sistemeve. Kjo përmirëson llogaridhënien e institucioneve zyrtare ose organeve të tjera publike.

8.1 Mbledhja e statistikave

- Niveli minimal i statistikave të kërkuara në lidhje me bashkëpunimin e brendshëm dhe atë ndërkombëtar - për shembull: të dhëna për numrin e hetimeve financiare dhe veprave penale përkatëse, numrin dhe vlerën e urdhrave të ngrirjes, numrin dhe vlerën e urdhrave të konfiskimit,

¹⁶ Shënim Udhëzues nr.10 i T-CY-së: Urdhrat e prodhimit për informacione rreth abonentit (Neni 18 i Konventës së Budapestit), <https://rm.coe.int/16806f943e>

¹⁷ Shih <http://www.coe.int/en/web/transnational-criminal-justice-pcoc/pc-oc-69th-meeting> and <http://www.coe.int/en/web/transnational-criminal-justice-pcoc/model-request-form-for-mutual-assistance-in-criminal-matters>

¹⁸ Shih:

<https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016802e726c>

numrin dhe vlerën e konfiskimeve të ekzekutuara; numrin e hetimeve/procedimeve penale/vendimeve për pastrimin e parave; statistikat e NjIF-it; bashkëpunimi ndërkombëtar: numrin e kërkesave hyrëse dhe dalëse të ndara nga nenet e konventave të Varshavës dhe Budapestit dhe dispozitat e brendshme.

- Garancia që statistikat përgatiten me një metodë të tillë që ato të mund të krahasohen ndërmjet njësive të ndryshme dhe që të mund të raportohet me saktësi totali vjetor.
- Emërimi i organit (njësisë) që do të mbledhë statistikat nga institucione të ndryshme (Policia, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave), organi i akuzës, gjykatat/gjyqësori, Ministria e Drejtësisë) dhe përkushtimi i tyre për t'i dërguar këto të dhëna. Të merren parasysh detyrimet e ndryshme të raportimit (Këshilli i Evropës: p.sh. MONEYVAL, GRECO, OECD) ose
- Caktimi ose krijimi i një organi për të mbledhur statistika:
 - Mandati i organit
 - Kompetencat për të kërkuar informacion nga institucionet përkatëse
 - Financimi
- Zhvillimi i klasifikimeve të përbashkëta për harmonizuar punën që bëhet nga institucione të ndryshme.

8.1 Analizimi i statistikave

- Monitorimi i incidencës mbi bazën e statistikave të mbledhura.
- Analizimi i statistikave nga Grupet Shumëpalëshe për të vlerësuar dhe rritur efikasitetin.
- Analiza vjetore e statistikave në takimet vjetore nga drejtuesit e institucioneve përkatëse.

9. Rekomandime për hartimin e protokolleve

9.1 Udhëzime të përgjithshme

Më poshtë paraqiten disa udhëzime të përgjithshme të cilave duhet t'ju referohemi kur krijohen, rishikohen dhe zbatohen protokollat e brendshme. Këto udhëzime nuk janë shteruese dhe procedura dhe legjislacion tjetër vendas duhet të ketë përparësi mbi këto rekomandime të përgjithshme:

- Të sigurohemi që kompetencat/mandatet e institucioneve të ndryshme të jenë paraqitur në protokoll
- Të sigurohemi që objektivat e protokollit të jenë përcaktuar qartë brenda tij
- Të sigurohemi që formulari i kërkesës për bashkëpunim/shkëmbim të informacionit të jetë i thjeshtë dhe jo i ngatërruar, e që nuk merr shumë kohë
- Të sigurohemi që agjencitë/institucionet të kenë specifikuar një pikë të vetme kontakti me autoritetin për të bashkëpunuar me institucionet e tjera
- Të sigurohemi se institucionet që kanë kompetenca për të kryer lloje të caktuara hetimesh/mbledhje të informacionit mund ta ndajnë lehtësisht këtë informacion me institucionet e tjera
- Të sigurohemi që masat, mbi bazën e të cilave do të ketë bashkëpunimin ndërinstitucional sipas protokollit, të jenë përcaktuar qartë, si në lidhje me bashkëpunimin e brendshëm, ashtu dhe me atë ndërkombëtar
- Të sigurohemi se ekzistojnë dispozita specifike në lidhje me zhvillimin, ngritjen dhe mirëmbajtjen e bazës së të dhënave të integruara të informacionit
- Të sigurohemi se janë integruar në protokoll masa të forta lidhur me konfidencialitetin, sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave

- Të sigurohemi se ekzistojnë procedura standarde pune të përcaktuara qartë për Grupet Shumëpalëshe.
- Të sigurohemi që Grupet Shumëpalëshe sipas protokollit të kenë përcaktuar strukturën e lidershipit
- Të sigurohemi se protokollit parashikon trajnim të përbashkët
- Të sigurohet se ekziston një mekanizëm gjithëpërfshirës llogaridhënie dhe monitorimi, përfshirë takimet e rregullta, mbledhjen e statistikave, etj.
- Të sigurohemi që operatorët e sektorit privat nxiten të bashkëpunojnë mbi baza joformale
- Zgjidhja e mosmarrëveshjeve:
 - Të sigurohemi që ekziston një procedurë për zgjidhjen e mosmarrëveshje që janë brenda dhe jashtë objektit të protokollit
 - Të sigurohemi se janë vendosur afatet e duhura kohore për të siguruar zgjidhjen e përsheptuar të këtyre mosmarrëveshjeve
 - Të sigurohemi se ekziston një mekanizëm që parandalon pengesën ndaj hetimeve në vazhdim dhe atyre të reja si rezultat i mosmarrëveshje midis institucioneve
- Mbyllja e protokollit
 - Të sigurohemi që të ketë një metodë për të revokuar ose mbyllur çdo protokoll, nëse kërkohet
 - Të vendoset një periudhë njoftimi për mbarimin e protokollit
 - Të sigurohemi që efekti i mbylljes së protokollit të jetë përcaktuar qartë, përfshirë ndikimin e EPH-ve, MAG-ve, hetimet dhe bashkëpunimi në vazhdim
- Afati ose periudha e protokollit
- Të identifikohet data kur protokollit hyn në fuqi
- Të specifikohet afati i protokollit
- Të sigurohet një opsion për rinovim, nëse është e nevojshme.

9.2 Ndryshime dhe shtesa të protokolleve

- Të specifikohet një procedurë për bërjen e ndryshimeve
- Të identifikohet mënyra se si mund t' i bëhen ndryshime protokollit të miratuar, përfshirë nivelin e konsensusit të kërkuar.
-